



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET

"HAXHI ZEKA"

MENAXHIMI I RISKUT

QASJET NË PËRKUFIZIMIN E RREZIKUT

Kapitulli 1

Prof. Asoc. Dr. Ibish Mazreku

Ph.D. Fisnik Morina



MARS, 2018



MENAXHIMI I RISKUT

2

- Lënda: Menaxhimi i Riskut
- Viti III-të, Semestri VI, Departamenti: KF
- Statusi i lëndes: Obligative
- Javët mësimore: 15 (2 orë ligjerata, 2 orë ushtrime)
- Mësimdhënes: Prof. Asoc. Dr. Ibish Mazreku
- Asistent: Ph.D. Fisnik Morina
- Emaili: ibish.mazreku@unhz.eu
fisnik.morina@unhz.eu

Hyrje

- **Menaxhimi i riskut** është disipline e re, e cila karakterizohet me një zhvillim të shpejte dhe pikëpamje të shumta, përshkrime të larmishme: se çfarë involvon ne vete, dhe si duhet të administrohet .
- Standardet në fjalë duhet siguruar se ekziston një përputhshmëri sa i përket:
 - terminologjisë lidhur me shprehjet (fjalët) e shfrytëzuara,
 - procesit sipas të cilit menaxhimi i riskut mund të performohet
 - strukturës organizative për menaxhimin e riskut, si dhe
 - qëllimit të menaxhimit të riskut.

Hyrje

- Fatmirësisht, standardet vejnë në pah atë se risku posedon si aspektin negativ (dobësues) ashtu edhe atë pozitiv (përfitues).
- Menaxhimi i riskut nuk ka te beje vetëm me korporatat apo organizatat publike, por për çdo aktivitet qoftë afatgjate apo afatshkurtër.
- Përfitimet dhe mundësit duhet shikuar jo vetëm ne aspekt te vete aktivitetit por edhe ne relacion me pjesëmarrësit e ndryshëm qe munde te involvohen.

Risku

- **Risku** mund te definohet si kombinim i probabilitetit të një ngjarjeje dhe pasojave te saj.
- Ne çdo ndërmarrje, ekziston mundësia e ndodhjes se ngjarjeve dhe pasojave te tyre të cilat karakterizohen me mundësi ngritjeje (përfituese) apo rënëse (kërcënuese).
- Gjithnjë e me shume është bërë e ditur se menaxhimi i riskut ka te beje si me aspektin pozitiv të riskut ashtu edhe me atë negativ.
- Prandaj ky standard e merr ne konsiderate riskun nga te dy perspektivat.
- Në një ambient të sigurt ku pasojat janë thjesht negative, menaxhimi i sigurt i riskut duhet fokusuar në parandalimin dhe lehtësimin (zbutjen) e dëmeve (pasojave)

Menaxhimi i riskut

- **Menaxhimi i riskut** është pjese qendrore (thelbësore) e menaxhimit strategjik të një organizate.
- Është proces me ane te se cilit organizatat ne mënyre metodologjike e adresojnë riskun si pjese përcjellëse te aktivitetit te tyre, me qellim te arritjes se përfitimeve te pandërprera ne secilin aktivitet si dhe ne te gjithë portfolion e aktiviteteve.
- Fokus i menaxhimit te mire te riskut është identifikimi dhe trajtimi i këtyre risqeve.
- Qëllimi e tij është te shtoj ne maksimum vlerën mbështetëse të të gjitha aktiviteteve te organizatës.

Menaxhimi i riskut

7

- Thekson (vë në pah) faktorët potencial nxitës si dhe ata rrënues të cilët mund të kenë ndikim në organizatë.
- Rrite probabilitetin për sukses, si dhe zvogëlon atë për dështim apo pasiguri në arritjen e objektivave të përgjithshme të organizatës.
- Menaxhimi i riskut duhet të jetë një proces i vazhdueshëm dhe zhvillimor, i cili realizohet përmes strategjisë së organizatës si dhe implementimit të asaj strategjie.
- Duhet të adresoni në mënyrë metodologjike të gjitha risqet e përafërta që kanë përcjellur organizatën në të kaluarën, në të tashmen, e në veçanti në të ardhmen.

Menaxhimi i riskut

- Duhet te integrohet brenda kulturës se organizatës, përmes një politike dhe programi efektive dhe duhet te udhëhiqet nga ana e menaxhmentit te larte.
- Duhet ta shndërroi strategjinë ne objektiva taktike dhe operacionale, duke përcaktuar përgjegjësitë brenda organizatës për secilin menaxher dhe punonjës përgjegjës për menaxhimin e riskut si pjese te përshkrimit te vendit te tyre te punës.
- Ndihton ne përcaktimin e përgjegjësisë, në vlerësimin e performances dhe shpërblimeve, kështu qe promovon efektshmërinë në të gjitha nivelet.

Evoluimi i riskut

- Fjala **risk** ka përdorim të përditshëm ndërsa mund të ketë interpretime të ndryshme, kjo nënkupton që riskun secili nga ne e kuptojmë në mënyrën tonë dhe secili nga ne e shpjegojmë në mënyrën tonë.
- Koncepti i riskut të cilin ne e njohim sot ka qenë gjithmone i lidhur me natyrën e njeriut kjo nënkupton vetë njeriun ndërsa në kohët moderne kjo ka kuptim më të gjërë ku përveç njeriut risku ka kuptimin edhe të natyrave tjera si domos në ato biznesore, politike, ekonomike etj.

Evoluimi i riskut

- Ndersa fjala Hazard rrjedh nga fjala arabe **al zahr** e cila e ka kuptimin e zares (Zare). Ndersa kuptimi modern i riskut apo rrezikut daton qysh prej 300 vjeteve me konkretisht me 1719 ku fjala Rrezik apo risk ka kuptimin e “ Shansa apo rreziku per humbje komerciale, specifikisht ne rast te sigurimit te prones apo te mirave”.
- Nese a analizojme mire gjenezen e fjales risk shohim qe risku daton shume heret qe ka vetedijesimi i njeriut per llojet e risqeve ndersa ne koherat modern fjala risk ka nderlidhshmeri me sigurimet.

Definimi i Riskut

- **Risku** mund te definohet si kombinim i probabilitetit të një ngjarjeje dhe pasojave te saj.
- Ne çdo ndërmarrje, ekziston mundësia e ndodhjes se ngjarjeve dhe pasojave te tyre të cilat karakterizohen me mundësi ngritjeje (përfituese) apo rënëse (kërcënuese).
- Gjithnjë e me shume është bërë e ditur se menaxhimi i riskut ka te beje si me aspektin pozitiv të riskut ashtu edhe me atë negativ.
- Prandaj ky standard e merr ne konsiderate riskun nga te dy aspektet.

Definimi i Riskut

- Në një ambient të sigurt ku pasojat janë thjesht negative, menaxhimi i sigurt i riskut duhet fokusuar në parandalimin dhe lehtësimin (zbutjen) e dëmeve (pasoja)
- Si nga autore të ndryshëm ashtu edhe në literature e shumëllojshme në lidhje me menaxhimin e riskut ka definicione të ndryshme në lidhje me këtë.
- Ne do të mundohemi të japim disa nga këto definicione të cilat konsiderohen si më të pershtashme apo më domethënëse.

Definimi i Riskut

- Sipas fjalorit te gjuhes angleze te Oxfordit riskun e definon si “ shanse apo mundesi e rrezikut, humbje, lendim apo ndonje konsekuence e pafavorshme “, ku sipas ketij definicioni risku definohet si dicka negative ku nje vleresimi tille nuk do te duhej te mirrej vetem nga qasje sepse risqet kane edhe impakt pozitiv.
- Ne jeten perditshme pasja apo perdorimi i makinave dhe paisjeve te ndryshme perveq qe eshte dicka qe na mundeson te jemi me mobil ajo ne vetevete ngerthen edhe rreziqet te cilat do te mund te ndodhin nga perdorimi i tyre qe nenkupton mundesia e ndodhjes se ndonje aksidenti te paparishikuar apo edhe aksidentimi dhe demtimi I njerezve dhe pronave te tyre.

Definimi i Riskut

- Me poshte do te mundohemi te japim disa nga disa definicionet te cilat jane munduar te japin dhe qartesojne sa me mire riskun :
- ✓ “ **Efekt i pasigurise ne objektivat.** Duhet te dini qe efekt mund te jete pozitiv, negativ ose devijim nga e pritshmja. Gjithashtu, rreziku eshte përshkruar shpesh nga nje ngjarje, nje ndryshim ne rrethanat apo pasojat” .
- ✓ “ **Rreziku** eshte kombinimi i probabilitetit te nje ngjarje dhe pasojave te saj. Pasojat /shkaqet mund te shkojne nga ato pozitive ne negative” .
- ✓ “ **Pasiguria e rezultatit** brenda nje game te ekspozimit qe rrjedhin nga nje kombinim i ndikimit dhe probabilitetin e nje ngjarje te mundshme” .

Definimi i Riskut

15

- Shume autor ne SHBA kane krijuar apo shkruar shume definicione ne lidhje me riskun siq jane:
 - ❖ Risku eshte mundesi e nje ngjarje fatkeqe
 - ❖ Risku eshte kombinim i hazardeve (rreziqeve)
 - ❖ Risku eshte i paparishikueshem – me tendence qe rezultatet aktuale mund te ndryshojne nga rezultaet e parashikuara
 - ❖ Risku eshte paqartësia e demit
 - ❖ Risku eshte mundesia e demit

Klasifikimi i Risqeve

- Me herët potencuam qe risku mund te ketë rezultate apo pasoja si pozitive ashtu edhe negative apo thjeshte mund te rezultojë ne pasigurinë për te ardhmen.
- Duke analizuar këto vijmë ne përfundim qe duke u ballafaquar me riskun mund te shohim si shanse, humbje apo edhe paqartësi për te ardhmen e organizatës.
- Secili risk ka specifikat e veta dhe kërkon një qasje organizata ne harmoni me këto karakteristika.

Klasifikimi i Risqeve

- Duke prezantuar ndarjen e risqeve sipas karakteristikave të tyre nuk mund të vijmë në përfundim që kemi ndarje të drejte apo jo të drejte të llojeve të risqeve.
- Këto dallime vijnë si rezultat e pikëpamjeve apo qasjeve të ndryshme që kanë autorë apo institucione të cilat merren me studimin e risqeve.
- Prandaj është shumë me rëndësi se çfarë klasifikimi të risqeve bën vete organizata varësisht nga specifikat e risqeve që kanoset organizata në fjalë.
- Secila organizatë bën listën e risqeve që ekspozohet dhe ndan specifikave të tyre.

Klasifikimi i Risqeve

- Risqet mund te klasifikohen sipas natyrës dhe tipareve te risqeve siç është shkalla e impaktit apo ndikimit si dhe natyra e ndikimit si dhe madhësia e riskut.
- Gjithashtu risqet mund te klasifikohen edhe sipas shkalles se impaktit edhe pasi ngjarja te ndodhe.
- Shume me rëndësi është edhe burimi i rreziqeve i cili mund te përdoret edhe si baze për klasifikim ku ne baze te kësaj risku klasifikohet sipas origjinës se tij.
- Ndërsa edhe një forme tjetër e klasifikimit është edhe ndarja për nga natyra e impaktit/efektit, p.sh disa risqe mund te ndikojnë ne financat e organizatës ndërsa disa tjerë mund te kenë efekt ne aktivitetet e ndërmarrjes.

Klasifikimi i Risqeve

- Ne shume sisteme kemi forma te ndryshme te klasifikimit dhe kjo do te duhej ti pershtatet ndermarrjeve adekuate duke u bazuar ne standarde te ndryshme.
- Nga kjo shohim qe nuk kemi një forme te klasifikimit universal i cili do te ishte i aplikueshëm ne çdo sistem.
- Ka korniza apo standarde te cilat shume lehte do te mund te adoptoheshin për te ju pershtatur ndermarrjeve ku mendohet te aplikohet sistemi i klasifikimit te risqeve.
- Eshte shume me rendesi se fare perceptimi kane njerëzit ne lidhje me rreziqet apo vete riskun.
- Risku nga shihet ne disa forma apo nga disa kende te ndryshme ku secila forme kompletton permabjtjen dhe kuptimin e saj.

Klasifikimi i Risqeve

- Fjala risk kuptohet si dicka si :
- **Risku si Shkak** (zjarri, vjedhja, termeti etj si shkaktare te demeve/pasojave per njeriun, biznesit, shtetin)
- **Risku si Gjase** (risku si probabilitet/ mundesi e ndodhjes se ndonje ngjarje me pasoja, gjase e ndodhjes apo mos ndodhjes se ndonje demt me pasoja ten ndryshme financiare, operacinale etj)
- **Risku si Objekt** (ka kuprimin e shiqimit apo kontaktit te njeriut apo ndonje objekti qe eshte me rrezik)
- **Si marres Risku** (ne jemi cdo dite marres rreziku, psh nese ngasim motor, kalojme rrugen, fluturojme me avio etj)

Klasifikimi i Risqeve

- Secili risk ka specifikat e veta dhe kërkon një qasje organizata ne harmoni me këto karakteristika.
- Duke pare qe kemi te bëjmë me specifika apo karakteristika te ndryshme te risqeve atëherë edhe risqet mund te ndahen ne disa lloje dhe ato janë (Hopkin, 2010) :
- **Hazard apo Risqet e thjeshta**
- **Risqet e kontrollueshme (pasigurisë)**
- **Risqet spekulative**

Klasifikimi i Risqeve

- Duke prezantuar ndarjen e risqeve sipas karakteristikave të tyre nuk mund të vijmë në përfundim që kemi ndarje të drejta apo jo të drejta të llojeve të risqeve.
- Këto dallime vijnë si rezultat e pikëpamjeve apo qasjeve të ndryshme që kanë autorë apo institucione të cilat merren me studimin e risqeve.
- Prandaj është shumë me rëndësi se fare klasifikimi të risqeve bëhet vetë organizata varësisht nga specifikat e risqeve që kanoset organizata në fjalë.
- Secila organizatë bëhet listën e risqeve që ekspozohet dhe ndan apo sipas specifikave të tyre.

Klasifikimi i Risqeve

23

- Secila organizate ne mënyre te vetëdijshme mund te pranoje edhe risqet te cilat do te mund te kishin impakt negative p.sh investimi ne tregjet financiare sidomos ne këtë kohe krize globale financiare.
- Risqet ndahen ne kete menyre (Dickson & Stein 1999) :
 - - Risqet financiare dhe Jo Finaciare
 - - Risqet e thjeshta dhe spekulative
 - - Risqet Themelore dhe te Veqanta

Niveli i Riskut

- **Niveli i riskut** ka te beje me Shpeshtesine (Frequency) e ndodhjes se nje ngjarje apo demit dhe me Ashpersine (Severiti) e demit ku shpeshtësia ka te beje me numrin e ngjarjeve / rasteve / demeve ndersa ashpërsia ka te beje me koston e demit/ ngjarjes.
- Ndersa kemi edhe nje përafrim kuptimesh ne lidhje me shpeshtesine qe ndryshe perdoret edhe fjala Gjasat ndersa per ashpersine sinonimi i saj eshte madhesia e demit
- Shume te rëndësishme janë edhe mundësia e ndodhjes se risqeve ashtu edhe madhësia e saj ku kjo do te mund te paraqitej përmes pasqyrimit ne hartën e risqeve e cila do te krijuar bazuar ne risqet qe ballafaqohet ndërmarrja.

Niveli i Riskut

- Kjo harte do te mund te ishte ne forma te ndryshme ku zgjedhja për formën do te ishte e ndërmarrjes ku kjo forme harmonizohet me specifikat e biznesit qe ushtron ndërmarrja.
- Harta me shume e përdorur për te paraqitur nivelin e risqeve te cilat ballafaqohet ndërmarrja ka te beje me atë e cila ne njërën shtylle paraqet madhësinë e risqeve ndërsa ne shtylle tjetër gjasat e tyre, këto te dyja janë ne relacion njëra me tjetrën.

Niveli i Riskut

Ne figurën me poshtë do te paraqesim këtë relacion i cili paraqet shkallen dhe nivelin e ndikimit te risqeve ne ndërmarrje :

18 Hyrje në menaxhimin e riskut




Figura 1.1 Gjasat riskut dhe mundësia

Niveli i Riskut

- Në boshtin vertikal është paraqitur madhësia e rrezikut që mund të jete ndërsa në boshtin horizontal gjasat dhe tere këtë kombinim fitojmë disa situata siç janë gjasat e ulët dhe shkalla e lartë, gjasat e ulëta dhe shkalla e ulët, pastaj gjasat e larta dhe shkalla e lartë dhe në fund gjasat e larta dhe shkalla e ulët, në të gjitha këto situata duhet të veproje në harmoni me interesat e saj, duhet të veproje duke iu përshtatur situatave të paraqitura në tabelle sepse mos përshtatja mund të shkaktoj probleme në punën dhe aktivitetet e saj.

Niveli i Riskut

- Përmes matricës ndërmarrja paraqet ne mënyre vizuale nivelin dhe llojet, madhësinë dhe gjasat për te gjitha rreziqet qe ballafaqohet ndërmarrja.
- Kjo matrice mund te dizajnohet varësisht nga dëshira e personave te autorizuar, ngjyrat do te shënjohen sipas nivelit apo shkalles se rrezikshmërisë.
- Një shembull konkret te menaxhimit te riskut ne nivelin strategjik kemi te rasti bashkimit te dy aviokompanive Delta Airlines dhe Northwest Airlines ku ky bashkim ne vetvete paraqet shume paqartësi dhe shume rreziqe ne te ardhmen e saj.

Niveli i Riskut

- Ku poenta e ketyre paqartësive ka te beje me mundësinë e ofrimit te gjitha benefiteve klientëve te prezantuar si me poshtë:
 1. Kombinimi i Delta dhe Northwest do te krijoje nje transportues global te SHBA-ve i cili do te mund te konkurronte me aviokompanite e huaja te cilat vazhdojne te rrisin shërbimet ne SHBA
 2. Klientët dhe komuniteti do te përfitojnë nga qasja ne sistemin e linjave global dhe ne nje aviokompani me stabile financiare
 3. Shume destinacione do te ofrojnë me shume opsione dhe mundësi te fitojnë dhe blejnë me shume milje fluturimi
 4. Klientët e Delta do te përfitojnë nga linjat e Northwest ne tregjet aziatike ndërsa Klientët e Northwest do te përfitojnë nga linjat e Delta ne tregjet tjera
 5. Delta dhe Northwest do te plotësojnë anetaresine ne SkyTeam aleancën do te lehtësoje integrimin e risqeve te cilat kane komplikuar disa bashkime te aviokompanive.